



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2019

**V E N D I M**

**Nr. 50, Datë 10/04/2019**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 22, datë 13.03.2019, e Z. E.C., ku pretendohet diskriminim, për shkak të “etnisë”, nga ana e shoqërisë italiane SGA spa.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, fillimisht ankuesi E.C. e informon Komisionerin, se në muajin qershor 2017, qeveria italiane shpalli falimentimin e Grupit Veneto Banca, nga ku u vendos që Intesa San Paolo Bank spa të përthithte pjesën e cilësuar si “*good bank*” të ish-Veneto Bank, e cila konsistonte në pjesën e performancës së mirë të bankave të këtij grupi, kapitalet, financimet, depozitat, asetet, hipotekat etj. Ndërkohë që, u vendos që një shoqëri italiane, që kishte si aktivitet të saj mbledhjen e borxheve të këqija, të merrte pjesën e ashtuquajtur “*bad bank*” të bankave të Grupit Veneto Banca. Shoqëria Italiane e Mbledhjeve të Borxheve quhet SGA spa, me seli në Napoli, Itali.

Z. E.C. ka qenë ish-punonjës i ish-Bankës Veneto, që pas shkrirjes me Intesa San Paolo Bank, u largua nga puna si pasojë e procesit të ristrukturimit. Njëkohësisht, Z. E.C. ishte edhe kredimarrës pranë Veneto Bank. Pas falimentimit të kësaj banke, ankuesi shprehet se është vënë në dijeni të faktit që kredia e tij është blerë nga SGA spa, pa kryer asnjë njoftim paraprak ndaj tij.

---

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Ankuesi pretendon se prona e tij e vendosur si kolateral pranë Veneto Bank sh.a. në Shqipëri, ka kaluar në favor të SGA spa, që është një shoqëri italiane që funksionon dhe operon sipas legjislacionit italian, pasi nuk është e regjistruar në Shqipëri. Ankuesi pretendon se në Shqipëri, SGA spa ka kontaktuar me Tranzit sh.p.k., ku kjo e fundit ka patur si detyrë të njoftojë klientët apo për t'u bëjë presion, me qëllim që të paguajnë kreditë, që kanë marrë si financime pranë ish-Veneto Bank sh.a., tashmë e falimentuar. Ankuesi shprehet se shoqëria italiane e mbledhjes së borxheve të këqija "SGA" spa ka kryer ndryshimin e inskriptit të pronës pranë ZRPP Tiranë, me anë të dy noterëve shqiptarë, fillimisht në favor të Veneto Bank sh.a. sipas Kontratës së Kredisë në favor të Veneto Banca spa-LCA, e në vijim në favor të SGA spa, pa dijeninë e Z. E.C. Banka e Shqipërisë e ka konfirmuar zyrtarisht në datën 18.01.2019, se kredia e Z. E.C. rezulton e shitur.

Ankuesi shprehet se noterët shqiptarë kanë kryer shkelje të rënda, duke kryer këto veprime, të cilët kanë çenuar pronën e tij, nëpërmjet tjetërsimit të saj në favor të një subjekti të huaj, që operon jashtë territorit shqiptar. Për të gjitha këto veprime, ankuesi pretendon se nuk është njoftuar, sikurse parashikohet në Kontratën e Kredisë. Ai sqaron se situata bëhet edhe më e rëndë, pasi në këtë rast nuk bëhet fjalë për një subjekt shqiptar, por për një subjekt të huaj, i cili sipas informacionit të marrë nuk rezulton të jetë i regjistruar në Shqipëri dhe nuk paguan detyrime tatimore. Ankuesi shprehet se ka depozituar kallëzim penal kundër SGA spa, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi asnjë institucion tjetër shqiptar nuk e mori përsipër ta shqyrtojë çështjen e tij. Ankuesi pretendon se në rastin konkret veprimi i SGA spa konsiston në grabitje prone.

**Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 22, datë 13.03.2019, së Z. E.C., Komisioneri gjykon se:**

Z. E.C. ka parashtruar ankesën e tij, ku pretendohet diskriminim për shkak të etnisë, nga ana e subjektit SGA spa, shoqëri italiane, e cila sipas informacionit të dërguar, nuk rezulton të jetë e regjistruar si e tillë në Shqipëri dhe si rrjedhim nuk operon sipas legjislacionit shqiptar.

Për sa më sipër, Komisioneri vë në dukje faktin se neni 4, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" parashikon shprehimisht subjektet ndaj të cilëve zbatohen dispozitat e tij. Përmbajtja e këtij neni parashtrohet si vijon: "1. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. 2. Shtetasit shqiptarë, me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare. 3. Personat fizikë e juridikë të huaj, me banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare."

Sikurse vihet re, mbrojtja që ofron institucioni i Komisionerit për personat fizikë apo juridikë, të huaj apo vendas, me banim brenda ose jashtë territorit shqiptar, lidhet në çdo rast me organet shtetërore shqiptare, ose në interpretim të zgjeruar të këtij neni, edhe ndaj subjekteve private vendase apo të huaja, që i nënshtrohen legjislacionit shqiptar dhe e zhvillojnë aktivitetin e tyre në Shqipëri, sipas këtij legjislacioni.

SGA spa është një subjekt i huaj, i cili nuk është i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, sipas dispozitave të ligjit nr. 9723, datë: 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, (i ndryshuar) dhe si i tillë nuk operon dhe nuk e zhvillon aktivitetin e tij, në zbatim të legjislacionit shqiptar dhe sidomos sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, (i ndryshuar).

Në këto kushte, Komisioneri gjykon se shqyrtimi i ankesës së Z. E.C. është jashtë kompetencave, që këtij institucioni i atribuon ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në referencë të nenit 33, pika 4, gërma b), Komisioneri gjykon se ankesa e depozituar nga Z. E.C. është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 1, nenin 4, nenin 7, pika 1, nenet 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pika 4, gërma b), të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I:**

1. Mospranimin e ankesës nr. 22, datë 13.03.2019, së Z. E.C., pasi kjo ankesë është e papajtueshme me dispozitat e ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Robert GAJDA**

**KOMISIONERI**

Shkak – etnia  
Fusha- te mira dhe sherbime